

PROJEKTI PER REHABILITIMIN EMERGJENT TE UJESJELLESVE

Statusi	Në zbatim
Huamarrësi	Republika e Shqipërisë
Koordinator projekti	Ministria e Punëve Publike
Kosto e projektit	US\$ 14.63 milionë
Shuma e kredisë	US\$ 10.0 milionë
Data e nënshkrimit	18 prill 2000
Data e bërjes efektive	14 korrik 2000
Data e mbylljes	1 mars 2003

□ Objektivat e projektit

Objektivi kryesor i projektit të propozuar për rehabilitimin emergjent të ujësjellësve është të mbështesë përpjekjet e qeverisë shqiptare për përmirësimin e shërbimit të sistemit të ujësjellësve në bashkitë e Durrësit, Fierit, Lezhës dhe Sarandës. Projekti për rehabilitimin urgjent të sistemit të ujësjellësit është një projekt pararendës i Projektit Bashkiak për Ujësjellës-Kanalizimet, i cili po përgatitet nga bashkitë e mësipërme. Projekti Bashkiak për ujësjellës-kanalizimet do të fusë pjesëmarrjen e sektorit privat në sektorin shqiptar të furnizimit me ujë në formën e një kontrate qeraje/administrimi. Projekti i Rehabilitimit Emergjent të Ujësjellësave do të mbushë hendekun midis situatës aktuale dhe projektit bashkiak për ujësjellës-kanalizimet me sipërmarrjen e sektorit privat në 1 ose dy vjet.

□ Përshkrimi i projektit

Projekti do të nisë një program prioritar afatshkurtër të inkuadruar brenda strategjisë së përgjithshme sektoriale. Në këtë kuadër, projekti do të rehabilitojë komponentë të sistemit të furnizimit me ujë, të cilët janë gati në shkatërrim apo të cilat kanë kosto tepër të larte pune apo rrezik shëndeti për shkak të gjendjes së tyre të amortizuar. Prandaj projekti do të ishte në gjendje të sillte përfitime domosdoshmërisht të nevojshme për të përmirësuar shërbimet bazë të ujësjellësit (në cilësi dhe sasi), me qëllim shmangien e shkatërrimit të sistemit; dhe reduktimin e kostonë së punës.

□ Arritjet e projektit

Konsulentit i RODECO-s përgjegjes për asistencën teknike ka përgatitur planin e rehabilitimit të investimit për vitin 2002 dhe studimin praparak (FS) për zonën rurale të Durrësit. Lokalizimi i rrjedheve (humbjeve) dhe komponenti i riparimit është përfunduar. Raporti baze për këto kompanie është në vazhdim.

□ Agjencite zbatuese

Ministria e Rregullimit Territorit dhe Turizmit, Drejtoria e furnizimit me Uje dhe Kanalizimeve dhe PIU ne Durres.

Personat e kontaktit

Drejtues ekipi

Andreas Rohde, ECSIN, Tel: 202-473-6672; Faks: 202-477-1386

**Konsulent në
zyrën e Tiranës**

Arben Bakllamaja, Tel: 355-42-40587/88/89; Faks: 355-42-40590
e-mail: abakllamaja@worldbank.org

Personi i kontaktit në qeveri

Genc Gjecaj, Drejtor i PIU Durrës
Tel: 355-52-22639; Faks: 355-52-22639; e-mail: shani@albmail.com